



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

Zyra për Regjistrim të Partive
Politike dhe Certifikim

Kancelarija për Regjistrim të
Partive Politike dhe Certifikim

Prishtinë / Pristina

Nr./Br. 161 / 04.03.2024

ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË
SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE
(KQZ) sipas paragrafit 1, të nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit
Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-
058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122, me datën 04.03.2024, merr këtë:

VENDIM

**Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar PARTIA DEMOKRATIKE E
ASHKANLIVE TË KOSOVËS**

- I. Subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, e regjistruar nga KQZ, me datën 19.07.2002, i shqiptohet gjobë, në vlerën katër mijë (4,000) euro, për shkak se, nuk ka dorëzuar raportin vjetor financiar për periudhën raportuese 2023.
- II. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.
- III. Mjetet e mbledhura nga pagesat e gjobave transferohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- IV. Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, ta paguaj gjobën e shqiptuar në vlerën katër mijë (4,000) euro, duke ia dorëzuar Zyrës, një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- V. Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, obligohet që brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi, ta dorëzoj në Zyrë, raportin vjetor financiar për periudhën raportuese 01.01.2023-31.12.2023.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, ka qenë e obliguar që më së voni, me datën 01.03.2024, ta dorëzoj në Zyrë, raportin vjetor financiar, për periudhën raportuese 01.01.2023 – 31.12.2023.

Zyra, para përfundimit të afatit për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të periudhës raportuese 2023, i ka dërguar njoftimet përmes e-mailit për obligimin ligjor për dorëzimin e raporteve vjetore financiare, te personat e autorizuar të subjektit politik, së pari me datën 16.02.2024 dhe së dyti, me datën 26.02.2024.

Subjektit politik i shqiptohet gjoba, në rast se nuk e ka dorëzuar raportin vjetor financiar, siç përcaktohet me paragrafit 1, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Ndërsa, shkelja për të cilën caktohet gjoba në rast të mos dorëzimit të raportit vjetor financiar, më së voni deri me datën 1 mars, është e përcaktuar në nën paragrafin 6.5, paragrafi 6, neni 21, Ligji nr. 08/L-122.

Subjekti politik i regjistruar, i cili nuk paguan gjobën e shqiptuar, nuk certifikohet në zgjedhje, siç përcaktohet me paragrafin 13, të nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 04.03.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

Kryetarit dhe përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të apelojë kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobës, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda pesë (5) ditëve të punës, pas njoftimit për vendimin.